

Kategoria Superiore/ Partizani – Kastrioti 1-0

nga AlbaniaSoccer
E diel, 24 Nentor 2013 16:10



Partizani ka arritur te marre nje tjetër fitore ne shtepi perballe tifozëve që e kanë perkrahur këte skuader edhe nen reshjet e pandalura te shiut. Te kuqte i jane faluar serish kembëve te arta te Julian Malos që ka mundur ti jape suksesin e deshruar te kuqve. Ne minuten e 14 sulmuesi ka derguar sakte topin ne porte nga pika e bardhe e penalltise duke mposhtur Ilion Likën. Ne minutat pas ketij momenti, Partizani eshte terhequr ne mbrojtje per te lene Kastriotin te luaj. Terreni I renduar nga shirat e shumte ja ka lehtesuar te kuqve punen. Deri ne fund te ndeshjes, pavarsisht perpjekjeve që kanë bere krutanet, rezultati nuk ka ndryshuar. Partizani ka marre tre pike te arta duke barazuar Teuten e vendit te dyte ne tabele dhe tani e shohin veten shume prane kreut te tabeles.